



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:008737
Datë: 04.08.2023
Numri i dokumentit: 04556160

C-IV-20-0045

Ankuesi

H D nga Prishtina,
Përfaqësuar nga N Th av nga Prishtina.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 04 gusht 2023, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- Dhoma e Posaçme jep pëlqimin për tërheqjen ankesës, ashtu që ankesa konsiderohet e tërhequr.**
- Ankuesi i bart shpenzimet gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 29 korrik 2020, ankuesi parashtrij ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (më tej AL) nr. PRN008-0105, datë 31 mars 2015, me të cilin ka kërkuar kompensim për pagimin e borgjit për paga të papaguara në shumë prej 5,397.00 € nga N.SH. “I.M.F Kosova” (në likuidim). Ankuesi më tej pohoi se e paditura nuk ka përmbushur në tërësi obligimin e saj për pagesë prej 100 %, sipas aktit të AL, për pagat e papaguara ka paguar vetëm 80 %, nga shuma neto ndërsa 20 %, nuk i ka paguar deri më tash. Ankuesi i propozon gjykatës që të aprovohet ankesa e tij si e bazuar dhe të detyrohet e paditura që ankuesit t’ia paguaj shumën e papaguar prej 20 %, e cila shumë është 5,397.00 € nga vlera neto e vendimit të AL, kamatën ligjore si dhe shpenzimet e procedurës. Në mbështetje të ankesës ka dorëzuar autorizimin për përfaqësim, vendimin e kundërshtuar dhe një ekstrakt të kërkesave në procedurë të likuidimit (i pa protokoluar).

Me 01 gusht 2023, ankuesi nëpërmjet përfaqësuesit të tij dorëzoi një parashtrësë për tërheqjen e ankesës duke e njoftuar gjykatën se ka arritur marrëveshje me zyrtarët e AKP-së, për çështjen kontestuese.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e ankuesit konsiderohet e tërhequr.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Gjykata pajtohet me tërheqjen e ankesës, sepse nuk është në kundërshtim me interesin e ndonjërës palë (neni 34.1 i Ligjit për Dhomën e Posaçme).

Neni 34.1 i Ligjit për Dhomën e Posaçme parasheh:

Paditësi mund ta tërheqë kërkesën apo ankesën e tij në çdo kohë me pajtimin e Dhomës së Posaçme. Me dhënien e pëlqimit të tillë, Dhoma e Posaçme merr parasysh interesin e të gjitha palëve tjera. Vendimi për dhënien e pëlqimit për tërheqje mund të përfshijë urdhërpagesën për shpenzimet e procedurës nga pala që tërhiqet. Vendimi i tillë nuk e ndalon palën nga parashtrimi i serishëm i kërkesës apo ankesës.

Në interpretim të dispozitës së lartcekur, gjykata konstaton se ankuesi mund ta tërheqë ankesën në çdo kohë, nëse nuk është në kundërshtim me interesin e njëjës palë. Në rastin konkret gjykata vlerëson se tërheqja e ankesës nga ana e ankuesit e bërë përmes parashtrësës, është bërë në pajtim me dispozitat ligjore dhe nuk është në kundërshtim me interesin e ndonjërës palë.

Nga kjo, gjykata konsideron se ankuesi nuk ka interes për të vazhduar procedurën në këtë çështje juridike dhe se në rastin konkret sipas dispozitave ligjore ankesa konsiderohet e tërhequr.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do të mbulojë shpenzimet e veta.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli,
Gjyqtar

Numri i lëndës: 2023:008737
Datë: 04.08.2023
Numri i dokumentit: 04556160